

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA E NOTERISË TIRANË  
Nr. 2651 Rep.  
Nr. 671 Kol.



### KONTRATË HUAJE

Sot, në Tiranë, më datë 15. 06. 2017 (dymijë e shtatembedhjete), përpara meje Edlira HYSENI, Noter pranë Dhomës së Noterisë Tiranë, me adresë në Bulevardin "Zogu I", në Katin e II, të Pall. me 12 kat, prane Godines se Zerit të Popullit, u paraqiten personalisht personat si më poshtë përshkruar:

Z. **Qemal BEKTESHI**, atësia Enver, lindur me 26.09.1964, ne Shkoder dhe banues ne Shkoder, lagje «Kongresi i Permetit», rruga «Musa Luli», Pallat i Ri ngjitur me Teatrin Migjeni, madhor, me zotesi te plote juridike e per te vepruar, mbajtes i leternjoftimit numer 025533744, dhe numer personal G40926092C, i cili përfekt të kësaj kontrate do të quhet **Huadhënës**;

dhe

Shoqeria "AL & GI" shpk, me seli ne Tirane, Rruga Reshit Çollaku, Pallati Classik Construction, e regjistruar si person juridik me numer NIPT J82020004P, e perfaqesuar ne kete akt nga administratori *Alban XHAFERI*, atësia Ejup, i lindur ne Tirane, me 07.04.1970 dhe banues ne Tirane, ne adresen rruga "Dervish Hima", Perballe Stadiumit "Qemal Stafa", madhor e me zotesi mbajtes i leternjoftimit numer 030172426 dhe numer personal H00407144F, që përfekt të kësaj kontrate do të quhet **Huamarrës**; të cilët më kërkuan redaktimin e kontratës së huasë si më poshtë:

### IDENTIFIKIMI I PALËVE

- Identitetin e Personave fizikë pale ne kontrate si edhe zotësinë e tyre përf të vepruar e identifikova mbështetur në Dokumentat e identifikimit personal paraqitur nga vetë personat fizike si edhe në prezencen fizike të seicilit. Konstatoj se seicili e ka zotësine juridike dhe përf të vepruar.
- Adresat e Personave fizikë vendosur ne hyrje të aktit deklarohen personalisht prej seicilit prej tyre.
- Unë noterja, nëpërmjet ekstraktit të Gjendjes së Rregjistrimit lëshuar nga QKR, verifikova gjendjen e rregjistrimit të shoqërisë "AL & GI" sh.p.k. pale ne kontrate dhe konstatoj se është shoqëri aktive dhe se Z. Alban XHAFERI është Përfaqësuesi i saj ligjor.

1



4. Përfaqësuesei ligjor më deklaron personalisht se Shoqëria është aktive, nuk është në proces falimentimi, nuk është në ndjekje penale, nuk është nën sekuestro apo nën forma të tjera të kufizimit të zotësisë së saj juridike dhe për të vepruar dhe se ai, Alban XHAFERI është Përfaqësuesi i vetem ligjor i saj.
5. Une noteria pranoj e shenoj edhe deklarimin e seicilit prej tyre se identifikimi si më sipër pasqyron realitetin.

Personat palë në kontratë më deklaruan se janë në dijeni të plotë të pasojave ligjore në rast të një deklarimi të pavërtetë dhe më parashtruan sa vijon:

#### Neni 1

#### RRETHANA PARAPRAKE

Huamarrësi shoqëria "Al & Gi" sh.p.k deklaron dhe pranon se do te marrë hua pa kamatë, nga Huadhenesi shumën prej ALL 10 000 000 (dhjetë milion) lekë. Kjo vlera do te jepet hua me keste dhe do te konsiderohet hua për një afat kohor prej 5 vjetësh. Ky afat fillon nga data e nenshkrimit te kesaj kontrate.

#### Neni 2

#### Objekti

Objekti i kësaj kontrate është pranimi se Huadhenesi do ti jape pa interes Huamarresit shumën prej 10 000 000 (dhjetë milion ) lekë.

#### Neni 3

#### Kohezgjatja

Kohëzgjatja e kësaj kontrate është 5 vjet, e fillon nga momenti I nënshtkrimit të kësaj kontrate. Kthimi I shumës së huasë do të bëhet nga Huamarrësi brenda afatit 5 vjeçar sa sipër.

#### Neni 4

#### Garancitë

Për hir të permëbushjes së detyrimit, kthimit të shumës, Huamarrësi garanton huadhënësin, duke lejuar vendosjen e sekuestros konservative mbi aksionet 105.363 aksione me vlerë nominale 1000 leke per aksion, pronë e shoqërisë "Al & Gi" sh.p.k, në shoqërinë "Birra Tirana", sh.a person juridik shqiptar, regjistruar pranë QKB me NIUS J61821051F, me seli në Tiranë, Rruga e "Kavajës" me administrator z. Alban Xhaferi. Keto aksione momentalisht jane te lira nga cdo barre dhe kufizim. Palet bien dakord qe kjo kontrate te depozitohet ne institucionet perkatese sebashku me vendimin e ortakut të vetëm të shoqërisë "Al & Gi" sh.p.k, për te bere te mundur vendosjen e kësaj

sekuestroje. Shoqëria "Al & Gi" sh.p.k, garanton se këto aksione janë të lira nga çdo lloj barre e nuk do të ngarkohen me të tilla përsa kohë zgjatë kjo mardhënie kontraktore.

Kjo pasuri, në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate do të rëndohet me barrë në favor të Huadhënësit dhe do të regjistrohet në Regjistrin e Barrëve Siguruese. Barra mbi këto aksione do të çlirohet vetëm nëpërmjet kërkesës me shkrim të Huadhënësit në këtë kontratë.

Nëse për arsyet e ndryshme nuk bëhet kjo kërkesë, huamarrësi me anë të deklartës notoriale dhe vërtetimit për kthimin e huasë ka të drejtë të çlirojë aksionet e tij nga sekuestroja e të kërkojë çrregjistimet përkatëse në QKB dhe Regjistrin e Barrëve Siguruese e për këtë Huadhënësi nuk do të ketë asnjë pretendim.

#### Neni 5

##### Të drejta dhe detyrime të huadhënësit


Huadhënësi, deklaron se do ta jape hua gjithë shumën e sipërpërmendur me transferë bankare, e Huamarrësi s'ka asnjë pretendim lidhur me këtë. Huadhënësi deklaron se shuma objekt kontrate vjen nga aktivitet I ligjshëm, në përputhje me gjithë ligjet Shqiptare në fuqi.

- Me mbarimin e afatit kontraktor për kthimin e shumës huadhënësi ka të drejtë të kërkojë përbushjen e detyrimit, të papërbushur tëresisht apo pjesërisht.
- Në rast mospërbushje në kohë të detyrimit huadhënësi ka të drejtë të kërkojë përbushjen e detyruar te tij duke e paraqitur këtë kontratë kudo që do ta çmojë të nevojshme, duke kërkuar lëshimin e urdhërit të ekzekutimit në gjykatë dhe ekzekutimin e titullit nëpërmjet Zyrës së Përbashimit Tiranë

#### Neni 6

##### Të drejta dhe detyrime te huamarresit

- Huamarrësi është i detyruar që shumën e marrë hua ta përdorë vetëm për ato aktivitete që nuk janë të ndaluara nga ligji Shqiptar.
- Huamarrësi është i detyruar që në momentin e përbushjes së detyrimit sipas afatit kontraktor t'i paguajë shumën huadhënësit Nëse huamarrësi për arsyet e caktuara nuk mund ta përbushë në kohë detyrimin e parashikuar në këtë kontratë, ai duhet ta njoftojë me shkrim huadhënësin dhe mund ta shtyjë afatin e përbushjes së detyrimit vetëm me miratimin e huadhënësit.
- Nese huamarrësi mund ta përbushi detyrimin e parashikuar në këtë kontratë përpara mbarimit të afatit të saj, huadhënësi është i detyruar të pranojë këtë përbushje dhe të çlirojë pronën nga barra e vendosur në Regjistrin e Barrëve Siguruese.



### Neni 8

#### E drejta për t'u tërhequr nga Kontrata

Palët në këtë kontratë kanë të drejtë që brenda 7 ditësh kalendarike nga nënshkrimi I saj të tërhojen nga kontrata. Nëse ndodh Huamarrësi duhet të kthejë gjithë shumën e huasë sa sipër, çka duhet të vërtetohet me deklaratën notoriale të Huadhënësit. Në të njëjtën deklaratë huadhënësi duhet të urdhërojë dhe fshirjen e sekuestros conservative mbi aksionet në QKB dhe në Regjistrin e Barrëve Siguruese.

### Neni 9

#### Dispozita të fundit

- Kjo kontratë hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të saj nga palët
- Çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin e kësaj kontrate do të zgjidhet me mirëkuptim, në të kundërt kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Kjo Kontratë u hartua prej meje noterit në katër kopje, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në nenin 1050 e vijues të Kodit Civil, dhe Kodin e Procedurës Civile, u lexua më zë prej meje, u kuptua dhe u nënshkrua nga palët me vullnetin e tyre të plotë, të lirë dhe të pavesuar dhe nëshkruhet rregullisht prej meje Noterit.

HUADHËNËS  
QEMAL BEKTESHI

*Qemal Beqteshi*  
*Alban Xhaferi*

HUAMARRËS  
Shoqëria "AL & GI" sh.p.k  
Përfaqësues Ligjor  
Alban XHAFERI

NOTERE  
EDLIRA S. HYSENI

*Edlira Hyseni*

